

Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës

Logo



Vizioni

Tranzicioni i suksesshëm i studentëve nga jeta universitare në rrugëtimet e tyre të pas-diplomimit bazuar në një kuptim të qartë të procesit të zhvillimit të karrierës, kredenciale konkurruese dhe zotërimin e strategjive bashkëkohore për identifikimin e mundësive të karrierës që reflektojnë interesat, aftësitë dhe aspiratat e tyre.

Misioni


Angazhimi për të ndihmuar studentët që të bëjnë lidhjen më të mirë mes përvojës së tyre akademike dhe udhëve të karrierës që do të ndjekin. Qendra e Karrierës ofron këshillime, orientim karriere dhe seminare për t'i ndihmuar studentët të qartësojnë qëllimet akademike dhe të karrierës, të krijojnë plane të karrierës, të zhvillojnë aftësitë e kërkimit të punës dhe të bëjnë një kalim të suksesshëm nga universiteti drejt tregut të punës. Ndërtimi i marrëdhënieve me studentë, Alumni, punëdhënës dhe institucione për të lehtësuar praktika studentore, punësim dhe mundësi karriere. Përmes bashkëpunimit të ngushtë me departamentet e Universitetit, Qendra asiston studentët në zhvillimin dhe artikulimin e përvojave bashkëkurrikulare që do t'i ndihmojnë ata të jenë konkurrues në përpjekjet e tyre për të ndërtuar një karrierë të suksesshme.

Më poshtë është një ilustrim në të cilin shenjohen elementët kryesorë dhe marrëdhëniet që duhen marrë në konsideratë në një situatë të re (siç është krijimi rishtazi i Qendrës së Karrierës), me synimin për të sjellë një impakt pozitiv.

Në konceptin e grupit të punës UAMD janë përfshirë **aktorët** më të rëndësishëm për Zyrën e Karrierës, ndër ta më të rëndësishmit janë stafi, studentët, alumni dhe biznesi.

Shërbimet që ajo do të kryejë. Theksi do të vihet në orientimin e karrierës, fuqizimin e të rinjve për të zhvilluar mundësitë e tyre për punësim, etj.

Dhe e kemi mbyllur me një **vlerë**. Vlerë për ne është mirëqenia e studentëve tanë, komunitetit të Durrësit, por edhe e mbarë vendit, e cila sigurohet përmes shërbimeve që zyrat e karrierës ofrojnë duke rritur punësimin.



AKTIVITETE

SHËRBIMET

Studentët

- Këshillim karriere
- Informim për mundësi punësimi/ internship
- Panairi i Punës
- Vullnetarizmi

Kompani

- Vendosja e bashkëpunimit (ndërlidhja)
- Takime të hapura
- Vizita Studimore
- Seminare
- Trajnime



Alumni

- Njoftime për punësim
- Shkëmbim përvojash
- Trajnime, seminare
- Workshop
- Rrjeti Alumni
- Çmimi i Karrierës

Staf Akademik

- Promovim të Qendrës së Karrierës
- Trajnime

Promocion Direkt

- Takime në auditorë
- Ditë informimi (orientation week)

Promocion Indirekt

- Website
- Newsletter
- Rrjete sociale
- E-mail
- Flyer/ Poster/ Broshura
- Guida studentore

MATRICA

<p>Krijimi i databazës Alumni <i>Sqarim: Gjurmimi i Alumni-t për të mësuar më shumë për zhvillimin e tyre në karrierë dhe sesi mund të ndihmojë kjo studentët dhe vetë universitetin</i></p>		Pamela												
<p>Alumni Talks <i>(referojuni aneksit 3)</i></p>	studentë	Xhaferi												
<p>Çmimi i Karrierës <i>Sqarim: Të gjithë ish studentët, që kanë arritur një nivel të lartë profesional, do të propozohen për “Çmimin e Karrierës”. Çmimi synon të promovojë arritjet tyre dhe të shërbejë si shembull për të gjithë ata që do të mbarojnë studimet pranë UAMD.</i></p>	Alumni													
<p>Histori Suksesi <i>Sqarim: Libërth i përvitshëm me historitë e suksesit në karrierë të ish-studentëve tanë</i></p>														

Nr.	Aktivitetet	Indikatorë	Viti Aktual	2021-2022	2022-2023
1	Javë informimi (Orientation Week)	Nr. i studentëve të informuar	2300	3000	3000+
	Informim mbi Qendrën e Karrierës	Nr. i studentëve të informuar në auditorë			
	Informim, përditësim i aktiviteteve mbi Karrierën në web; rrjete sociale				
2	Këshillim Karriere	Nr. i studentëve		500	700
	Prezantime nga Kompani	Nr. i kompanive		15	20
	Trajnim për CV, Letër Motivimi, intervistë	Nr. i trajnimeve Nr. i pjesëmarrësve	1 20	9 200	18 400
	Trajnim online (2 orë) për CV, Letër Motivimi, Teknikat e intervistimit	Nr. i trajnimeve Nr. i pjesëmarrësve	2 50	4 50	4 100
	Leksione të hapura, Seminar, workshop			5	9
	Panair i Punës	Nr i kompanive Nr i pjesëmarrësve Aplikime		30 2000 100	50 2000+ 200
4	Krijimi i Rrjetit UAMD Alumni	Nr i anëtarëve Nr i kontakteve Nr i gjurmimeve			
	Krijimi i databazës Alumni				
	Alumni Talks	Nr . aktiviteteve Nr. i pjesëmarrësve		9 200+	9 200+

Histori Sukses	Nr. i të intervistuarëve/profileve	20	30+
	Nr. i publikimeve	1	1
Çmimi i Karrierës	Nr. i konkurrëntëve	7	7
	Nr. i pjesëmarrësve	100	100+

BUXHETI

Nr.	Aktiviteti	Cope/çmim	Totali
1	Bazë materiale (Zyrë në Kampus)	1/300.000	300.000
2	Panairi i punës në UAMD <ul style="list-style-type: none">• Stenda• Shpenzime udhëtimi• Materiale promocionale	10/35.000 5/5000 30.000	400.000
3	Promovim <ul style="list-style-type: none">• Java e Informimit UAMD• Fletëpalosje• Guidë studentore• Rrjete sociale• Hapësira mediatike		300.000
4	Trajnime <ul style="list-style-type: none">• Bazë material (flipchart, bllok, marker, stilolaps etj)	1/5000	50.000
5	Zoom Account	1600 lek/Muaj	16000
6	Portali	1/1.500.000	1.500.000
	Totali		2.566.000
	Prej të cilave:		
•	Donator		1.500.000
•	Kompanitë në Panair		400.000
•	UAMD		810.000

Aneksi 1

Agjenda e trajnimit 1-ditor me temë: “Jetëshkrimi, Letra e Motivimit dhe përgatitja për Intervistë”

Përmbledhje: Trajnimet do të jenë të përmuajshme. Ato zhvillohen 10-ditëshin e parë të muajit. Përmes prezantimeve dhe ushtrimeve të ndryshme, studentët do të njohin më mirë njëri-tjetrin si dhe do të mësojnë llojet e CV-ve dhe sesi të hartojnë një CV profesionale, përmirësimin e shkathhtësive të shkrimit të letrës së motivimit dhe aftësitë komunikuese për të kryer një intervistë të suksesshme.

<i>Fillimi</i>	<i>Mbarimi</i>	<i>Tema</i>	<i>Objektivat</i>	<i>Rezultatet e pritshme</i>
09.00	09.15	Rregullat e trajnimit. Prezantimi i përmbajtjes dhe detajet administrative të trajnimit	- Informimi i studentëve për kategoritë e një CV; - Aftësimi i studentëve për hartimin e CV-së;	Studentët do të: - mësojnë të shkruajnë një CV; - dinë të dallojnë çfarë duhet të bejnë dhe çfarë nuk duhet të bejnë në hartimin e CV; - mësojnë të hartojnë letrën e motivimit; - njohin aftësitë që ndihmojnë në procesin e intervistimit; - mësojnë çfarë duhet të kenë parasysh gjatë intervistës së punës.
09.15	10:15	Prezantimi i rregullave të hartimit të CV-së	- Mësimi se si hartohet një letër motivimi; - Pajisja e studentëve	
10:15	11.15	Punë në grupe: Hartimi CV-së	me aftësitë e duhura komunikative për procesin e intervistimit;	
11.15	12.10	Prezantimi i rregullave të hartimit të Letrës së Motivimit	- Zhvillimi i njohurive nëpërmjet punës në grupe dhe roleve simuluese.	
12.10	13.00	Pushim dreke		
13:00	14:00	Punë në grupe: Hartimi i Letrës së Motivimit		
14:00	15:00	Aftësitë komunikative në intervistë		
15:00	15:45	Role-play Intervista		
15:45	16:00	Vlerësimi i trajnimit		

Aneksi 2

Seminaret e Zhvillimit Personal

Mësoni të udhëhiqni! Udhëhiqni nga Shembulli!

Përmbledhje: Seminaret do të zhvillohen semestrin e dytë të vitit akademik 2019-2020 (nga muaji shkurt, deri në qershor), sipas temave dhe të mëposhtme. Ato të mbahen nga staf i kualifikuar i UAMD-së ose të ftuar të nderit.

Shkurt 2020

Komunikimi efektiv dhe aftësitë e buta

Me rrënjët e saj në të dhënit dhe të ndarit, ironia është se fjala komunikim shpesh keqkuptohet. Një proces që shumë prej nesh e merr për të mirëqenë, është më kompleks nga ç`duket. Një pasqyrë e strategjive të suksesshme për përmirësimin e komunikimit, praktikimi i teknikave të duhura verbale dhe jo-verbale; të komunikuarit aty ku ka diferencë të menduari, zhvillimi i aftësive të dëgjimit aktiv do të sjellin përfitime të rëndësishme për pjesëmarrësit.

Mars 2020

Bazat e Lidërshiptit

Përmirësimi i vetëdijes - të kuptuarit e vetes dhe të të tjerëve
Të njohurit e mirë të vetes ndihmon në krijimin e marrëdhënie më të mira dhe një jetë më të kënaqshme. Një nivel i mirë i vetë-ndërgjegjësimit është gjithashtu themeli për ndërtimin e besimit dhe vetëbesimit. Seminari mbulon mjetet për të kuptuar veten, identifikimin e pikave të forta dhe të dobëta, menaxhimin e sjelljes, etj. Pjesëmarrësit do të kuptojnë gjithashtu kompleksitetin e teorisë dhe praktikës së udhëheqësisë dhe zhvillojnë vetëdijen për identitetin e tyre si udhëheqës.

Prill 2020

Përmirësimi i performances personale

Kultura jonë e drejtuar kah arritja me çdo kusht dhe brenda një kohe të shkurtër e qëllimit mund të mos jetë mënyra më efektive për të arritur rezultate, ndërsa të performuarit mirë është gjithmonë karakteristikë e kërkuar në tregun e punës. Marrja e “përgjegjësisë personale” është një rrugë e sigurt për sukses, por realizimi i saj nuk është aq i lehtë sa duket. Ky seminar mbulon teorinë, konceptet dhe modelet e të mësuarit. Pjesëmarrësit do të mësojnë si të marrin kontrollin e situatës dhe të vendosin objektiva realë dhe të arritshëm, si të tejkalojnë pengesat, si dhe të kenë mendësinë e duhur dhe monitorojnë progresin e tyre.

Maj 2020

Strategjia dhe Prioritizimi

Në këtë seminar, studentët do të mësojnë si të peshojnë përgjegjësitë dhe vendosin përparësitë në periudha të ndryshme të jetës së tyre; si të hartojnë një plan për menaxhimin e kohës. Ata do të kuptojnë marrëdhënien midis udhëheqësisë dhe stresit si dhe do të mësojnë mbi metodat për kujdesin personal.

Qershor 2020

Vendosja e Qëllimeve dhe Suksesi

Arritja e një qëllimi pa qenë të fokusuar është si të ngarit e një biçikletë pa pedalar. Përfundimi: rrëzimi është i sigurtë! Plot njerëz punojnë shumë ditë pas dite, por shohin që nuk po arrijnë gjëkund, prandaj duke mësuar si të vendosen objektivat e duhur individit lëviz nga të menduarit rreth listës së dëshirave drejt arritjes së tyre në të vërtetë. Ky seminar mbulon mjete për të vendosur se çfarë është e rëndësishme, ju ndihmon për të identifikuar qëllimet tuaja, si dhe hedhur hapat e parë drejt realizimit të tyre.

Aneksi 3

Rrjeti Alumni UAMD - Kalendar i Aktiviteteve '20-'21

Përmbledhje: Çdo javë të fundit për çdo muaj të vitit akademik 2019-2020, do të mbahen takime me të Alumni të ftuar. Ata do të rrëfejnë për studentët historitë e tyre në karrierë.

Nëntor

Profil Alumni
Alumni Talks
Pritje e Rrjetit Alumni nga Rektori

Dhjetor

Profil Alumni
Alumni Talks

Janar

Profil
Alumni Talks

Shkurt

Profil
Alumni Talks

Mars

Profil
Alumni Talks

Prill

Profil
Alumni Talks

Maj

Profil
Alumni Talks

Qershor

Çmimi i Karrierës
